VENDIM
Nr. 60/2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 99/2017 "PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT 'PËR QEVERISJEN VENDORE', NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 99/2017 "Për ngritjen e nënkomisionit 'Për qeverisjen vendore', në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut", të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

I. Deputeti Adnor Shameti caktohet anëtar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 16.5.2019.